

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"TOK – PARTNERS NETWORK" SH.P.K.**

Sot, më datë 22.11.2022, në Tiranë, në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, si dhe me parashikimet, e Ligjit nr. 55/2018, ne, ortakët: Enkelejda Mezinë, shtetase shqiptare, e bija e Kujtimit dhe Engjëllueshes, lindur në Tiranë, më 01/11/1972, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033751748, dhe Florjan Piperi, shtetas shqiptar, i biri i Dhimitraqit dhe Violetës, lindur në Vlorë, më 05/03/1978 dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037031868, dhe nr. personal H80305061H, me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnetin tonë të plotë dhe të lirë vendosim të krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "TOK – Partners Network" SHPK, Akti i Themelimit të së cilës hartohet me këto kushte:

**Neni 1  
Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "TOK – Partners Network" Sh.P.K., e njohur me shkurtimin "TOK Partners", (në vijim "Shoqëria").


**Neni 2  
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: "Rezidenca "Kodra e Diellit", Rruga e Jaseminëve, Z3, nr. 86".

**Neni 3  
Objekti i Shoqërisë**

3.1 Shoqëria ka si objekt veprimtarie si më poshtë vijon:


- Ofrimin e shërbimeve ligjore dhe financiare për persona fizik dhe juridik, shqiptar dhe të huaj;
- Përfaqësim i këtyre personave para institucioneve të ndryshme publike ose private, si përfaqësim në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor;
- Kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji "Për Profesionin e Avokatit" dhe legjislatiioni tjetër në fuqi. Shërbime konsulence në fusha të ndryshme;
- Këshillime për çështje ligjore. Hartim dokumentacioni për klientë dhe të tretë;
- Përfaqësimin në gjykatat e çdo shkalle të sistemit gjyqësor shqiptar në fushat civile, administrative, tregtare, penale, etj;
- Pregatitjen e kërkesave të arbitrazhit, ndërmjetësimit, vendas ose të huaj, për përfaqësimin ligjor të entiteve private apo publike në procese arbitrazhi, ndërmjetësimi apo çdo forme tjetër të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve;
- Këshillim, konsulencë dhe përfaqësim i shoqërive tregtare për çështje të administrimit të brendshëm tregtar të tyre;
- Përpilimin e akteve që vërtetohen nga noteri;



- Negocimi, ndërmjetësimi, hartimi dhe shqyrtimi i marrëveshjeve tregtare, kontratave civile dhe administrative, projekt-ligjeve, manaxhimin e projekteve, si dhe çdo dokument tjetër që synon të sjellë pasoja juridike për palët;
  - Ofrim këshillimi dhe konsulence për organizmat tregtare qeveritare, organizatat jofitimprurëse, fondacionet, institucionet shtetërore, ministritë, departamentet qeveritare dhe autoritetet publike dhe në veçanti konsulencë në lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun, konsulence për taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerezore dhe konsulencë të përgjithshme për shoqëritë që veprojnë në sektorët e shkencave sociale, biznesit dhe të industrisë;
  - Vlerësimi i impaktit dhe rrezikut të ideve, nismave dhe projekteve;
  - Ofrim i shërbimit të trajnimit, rritje kapacitetesh profesionale dhe edukim në vazhdim
  - Organizimi i eventeve me qëllim trajnimin e personave pjesëmarrës në platformën e krijuar me partner, bashkëpunëtor dhe persona të interesuar për bashkëpunime;
  - Vlerësimin e zhvillimeve të tregut brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatshme të informimit për personat juridikë dhe fizikë të interesuar, vendas dhe të huaj, ashtu siç mund të kërkohet prej tyre;
  - Konsulencë për administrimin, shitblerjen, dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industriale, publike apo private duke përfshirë pa u kufizuar në: ndërmjetësim për kryerjen e veprimeve të mësipërme midis personave juridikë privat apo publik, vendas apo të huaj dhe personave fizik, marketing, ekspertize shitjeje, menaxhim prone;
  - Organizim eventesh, seminaresh, sesione trajnimi ose konferencash në kuadër të objektit të shoqërisë me pjesëmarrje personalitetesh, vendas apo të huaj, që lëvrojnë aktivitet akademik, shkencor, shkëmbim idesh apo përmirësim të kapaciteteve intelektuale dhe organizative që lidhet me objektin e shoqërisë;
  - Kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtëpërdrejtë ose jo me:
    - i. njeriun dhe të drejtat e tij;
    - ii. zhvillimin hapësinor dhe kapaciteteve intelektuale;
    - iii. fushën fiskale, financiare, ekonomike, arkitekturore, mjedisore, bio, agro, energji, art dhe kulturë, mjekësi;
  - Kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtëpërdrejtë ose jo me përmbushjen në tërësi të objektit të sipërpërmendur të shoqërisë.
- 3.2 Shoqëria organizon dhe administron platformën e bashkëpunimit “TOK - for the best solution” me partner, bashkëpunëtor dhe persona të interesuar për bashkëpunime;
- 3.3 Gjithashtu për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tregtar, të aplikojë dhe marrë pjesë në platforma bashkëpunimi si dhe të aplikojë për marrje leje dhe licencash që e vlerëson të dobishëm apo të nevojshëm për arritjen e qëllimeve të saj, në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.






**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 100 (njëqind lekë).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, të nënshkruara të gjitha, me vlerë nominale nga 50 Lekë (pesëdhjetë lekë) secila.

**Neni 6**  
**Kontributet**

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar nga ortakët e mëposhtëm në shumat e poshtme:

- Zj. Enkelejda Mezini, shtetase shqiptare, e bija e Kujtimit dhe Engjëllueshes, lindur në Tiranë, më 01/11/1972 dhe banuese në Rruga "Siri Kodra", pallati 79/1, H.1, ap.10, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033751748, dhe nr. personal H26101051D, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, **e cila ka kontribuar në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë;** dhe
- Z. Florjan Piperi, shtetas shqiptar, i biri i Dhimitraqit dhe Violetës, lindur në Vlorë, më 05/03/1978 dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037031868, dhe nr. personal H80305061H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, **i cila ka kontribuar në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë.**


6.2 Sipas kontributeve të mësipërme, zotërimi i kuotave të Shoqërisë pasqyrohet si më poshtë vijon:

- Zj. Enkelejda Mezini, shtetase shqiptare, e bija e Kujtimit dhe Engjëllueshes, lindur në Tiranë, më 01/11/1972 dhe banuese në Rruga "Siri Kodra", pallati 79/1, H.1, ap.10, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033751748, dhe nr. personal H26101051D, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, **të cilës i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 50% (pesëdhjetë për qind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë;**
- Z. Florjan Piperi, shtetas shqiptar, i biri i Dhimitraqit dhe Violetës, lindur në Vlorë, më 05/03/1978 dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037031868, dhe nr. personal H80305061H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, **të cilit i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 50% (pesëdhjetë për qind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë.**

**Neni 7**  
**Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

**Neni 8**  
**Administratori/ët**



8.1 Me këtë akt emërohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rinovimi, personi si më poshtë:

- Z. Florjan Piperi, shtetas shqiptar, i biri i Dhimitraqit dhe Violetës, lindur në Vlorë, më 05/03/1978 dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037031868, dhe nr. personal H80305061H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

8.2 Kompetencat e Administratorit përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

#### Neni 9

#### Kopjet

Ky Akt Themelimi është bërë në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë secila.

#### ORTAKËT

Zj. Enkelejda Mezini

Enkelejda Mezini

Z. Florjan Piperi

Florjan Piperi

Tiranë, më 22.11.2022